



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:295176
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05478909

Ac.nr.8047/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit dhe Besnik Feka dhe Malsor Kryeziu – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Gj. P. me numër personal xxxx, me vendbanim në rrugën xxxx, në P, të cilën me autorizim e përfaqëson, av. S. M. nga P., kundër të paditurit H. P. me numër personal xxxx, me vendbanim në rrugën xxxx në P. të cilin me autorizim e përfaqëson av. H. K. nga P., për shkak të shpërnguljes dhe lirimit të banesës, vlera e kontestit 3,100.00 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.2897/21, të datës 10.08.2022, në seancën të kolegjit të mbajtur me datë 19.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurit H.P. nga P., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.2897/21, i datës 10.08.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë, me Aktgjykimin e ankimuar .nr.2897/21 i datës 10.08.2022 ka vendosur në këtë mënyrë:

- I. APROVOHET** në tersi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Gj. P. nga Prizreni.
- II. DETYROHET** i padituri H. P. nga P., që të shpërngulet dhe të lirojë nga të gjitha personat dhe gjësendet banesën e cila gjendet në Prizren në xxxxxx e evidentuar si njësi kadastrale nr.0-71813068-02752-2-1033-5360 në sipërfaqe prej 92 m2, ZK në Prizren si dhe garazhit e evidentuar si njësi kadastrale nr.0-71813068-02752-2-1033-166-0 në sipërfaqe prej 14 m2, ZK në Prizren, pronë e paditëses në bashkëpronësi me nga ½ pjesë ideale Gj. P. dhe E. P., në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

III. DETYROHET i padituri t'ia kompensoj paditëses shpenzimet e procedurës në shumë prej 509.00 €, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi të gjykatës së shkallës së parë, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i padituri për shkak të shkeljes esenciale të dispozitve të LPK-së, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim si në ankesë.

Paditësja nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë 30.12.2021 ka parashtruar padi kundër të paditurit, për lirim të pronës.

Gjykata e shkallës së parë në këtë çështje juridike-kontestimore, me qëllim të vertetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat dhe më pastaj ka vendosur si në dispozitivin e Aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e Aktgjykimit të atakuar ndër të tjera theksohet se nga çertifikata pronësore me nr.O-71813068-02752-2-1033-5-36-0 ZK Prizren, gjykata vërtetoi faktin se paditësja Gj. (B.) P. K. së bashku me E. (N.) P., janë pronarë me të drejtën e pronës prej ½ pjesë ideale, nënqiramarrje 99 vjet, të njësisë kadastrale nr.O-71813068-02752-2-1033-5-36-0, me sip. të përgjithshme prej 92 m², lloji i ndërtesës për banim, me shfrytëzim aktual banesë, kati VII, hyrja 5. Pronësi kjo e kaluar në bazë të trashëgimisë, LRP.nr.9720/2021 Ref.T.nr.1199/2021, i dt.21.09.2021, nga zyra Noteriale A. B.. Nga çertifikata pronësore me nr.O-71813068-02752-2-1033-7-166-0 ZK Prizren, gjykata vërtetoi faktin se paditësja Gj. (B.) P. K. së bashku me E.(N.) P., janë pronarë me të drejtën e pronës prej ½ pjesë ideale, nënqiramarrje 99 vjet, të njësisë kadastrale nr. O-71813068-02752-2-1033-7-166-0, me sip. të përgjithshme prej 14 m², lloji i ndërtesës Garazhdë, me shfrytëzim aktual garazhdë, kati IB, hyrja 7. Pronësi kjo e kaluar në bazë të trashëgimisë, LRP.nr.9720/2021 Ref.T.nr.1199/2021, i dt.21.09.2021, nga zyra Noteriale A. B.. Nga aktvendimi noterial me nr. LRP.nr.9720/2021, nr. të referencës T.nr.1199/21, i dt.21.09.2021, i përpiluar pranë Zyrës Noteriale Aliriza Beshi, gjykata vërtetoi faktin se është bërë shpallja e trashëgimisë për të ndjerin N. (H.) P., ish nga Prizreni dhe si trashëgimtar të tij janë shpallur bashkëshortja Gj. (B.) K. P. dhe i biri i mitur E. (N.) P.. Të njejt të drejtën e pronësisë e kanë fituar për ngastrën ZK Prizren, nënqiramarrje 99 vjet, banesa me nr.O-71813068-02752-2-1033-5-36-0, me sip. të përgjithshme prej 92 m² dhe garazhda me nr.O-

71813068-02752-2-1033-7-166-0, me sip. të përgjithshme prej 14 m², në vlerë prej 60.000 euro. (më gjerësisht si në aktin noterial nr. LRP.nr.9720/2021, nr. të referencës T.nr.1199/21, i dt.21.09.2021, i cili gjindet në shkresat e lëndës). Nga raporti mjekësor të lëshuar nga QKUK, i dt.25.05.20222, lëshuar në emër të H. P., gjykata vërtetoi se pacienti, në rastin tonë i padituri, është i hospitalizuar në Klinikën e Kardiologjisë, në QKUK Prishtinë. I njeji ka probleme me zemër, mbyllje kritike të arterieve kryesore të zemrës. Nga faturat-garancitë me nr.106-502/145725-1, i dt.19.03.2019; me nr.106-5020/70838-1, i dt.25.10.2014; me nr.106-004/158-1, i dt.19.03.2019; me nr.106-502/81734-1, i dt.18.03.2017, me nr.106-502/118168-3, i dt.31.05.2018, të gjitha këto të lëshuar në emër të N. P., nga dyqani N.-shitoret në P., gjykata vërtetoi faktin se janë lëshuar fletëgarancionet për paisje shtepiake, të blera nga N.P.. Nga monitorimi i transaksioneve të llogarisë në emër të N. P. për periudhën prej dt.01.01.2018 deri me dt.31.12.2018 dhe monitorimi i transaksioneve të llogarisë në emër të N. P. për periudhën prej dt.01.01.2019 deri me dt.31.12.2019, gjykata vërtetoi faktin se me datat: me dt.22.08.2018, është bërë pagesa prej 20.000 euro, me dt.03.09.2018, është bërë pagesa prej 6.000 euro, me dt.27.11.2018, është bërë pagesa prej 6.000 euro, me dt.03.12.2018, është bërë pagesa prej 1.500 euro, me dt.05.06.2019, është bërë pagesa prej 5.000 euro dhe me dt.23.09.2019, është bërë pagesa prej 6.500 euro. Të gjitha këto pagesa janë bërë në emër të Kabashi-2- N.T.SHPK, për blerjen e banesës në njësinë kadastrale nr.02752-2, me nr. LP:P-71813068-02752-2. Nga certifikata e pronësis me nr. 0-71813068-07149-0-273-1-20-0 ZK Prizren, gjykata vërtetoi faktin se i padituri H. (I.) P. është pronarë i banesës, me të drejtën e pronës 1/1 të pjesës ideale, me sip. të përgjithshme prej 69 m², lloji i njësisë Pjesa e ndërtesës, lloji i pronës private. Nga fletëlëshimi i QKUK-së në Kosovë, të dt.04.06.2022, në emër të H. P., gjykata vërtetoi faktin se H.P., konkretisht i padituri, është mjekuar nga dt.17.05.2022 deri me 04.06.2022, në QKUK, konkretisht në shërbimin e Kardiologjisë. Nga shikimi në 12 fotografitë e dorëzuara nga i autorizuari i të paditurit, në të njejtat rezultojnë qaste familjare mes palëve ndërgjyqëse dhe antarëve të tjerë të familjes. Nga vendimi i departamentit të pensioneve, të dt.08.03.2022, për Sh. P., gjykata vërtetoi faktin se është miratuar kërkesa e Sh. P., nga P., në kompensimin për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të dytë prej dt.28.02.2022, në shumën prej 150 euro. E njejta është bashkëshortja e të paditurit. Nga kontrata me nr.151889, e dt.06.11.2019, e lidhur mes H. P. – H. dhe A. P. -bashkëhuamarrëse si dhe F.-huadhënëse, gjykata vërtetoi faktin se është lidhur kontrata mbi huan mes palëve të lartcekura në shumë të huas prej 1,000 euro. Nga kontrata me nr.172915, e dt.24.08.2020, e lidhur mes H. P. - Huamarrës dhe F.-huadhënëse, gjykata vërtetoi faktin se është lidhur kontrata mbi huan mes palëve të lartcekura në shumë të huas prej 2,000 euro. Nga kontrata me nr.198201, e dt.15.06.2021, e lidhur mes H. P. - Huamarrës dhe F.-huadhënëse, gjykata vërtetoi faktin se është lidhur kontrata mbi huan mes palëve të lartcekura në shumë të huas prej 1,000 euro.

3.Baza ligjore

Gjykata vlerëson se bazuar në nenin 93 të Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDS), që është tani në fuqi, paditësi (pronari) ka të drejtë të kërkojë kthimin në posedim të ngastrave kadastrale të përshkruar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, nga mbajtësi këtu i padituri këto ngastra i posedon dhe i shfrytëzon pa ndonjë bazë të vlefshme juridike. Ndërsa kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 46 parag. 1 thotë: “E drejta e pronës është

e garantuar”, ndërsa parag. 3 thotë: “**Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona**”. Edhe protokollu 1 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në nenin 1 thotë: “Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”.

4.Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Nga provat e administruara, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike, nuk del të jetë kontestues fakti se paditësja është bashkëpronare së bashku me djalin e sajë me nga ½ në banesën kontestuese, dhe se këtë të drejtë e kishin fituar mbi bazë e të drejtës së trashëgimisë. Ndërsa, kontestuese ishte çështja nëse i padituri me familjen e tij, duhet të largohen nga banesa dhe të njëjtën t’ia lënë në posedim dhe shfrytëzim të lirë paditëses. Nga të lartcekurat, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja Gj.P., e lindur K., është pronare së bashku me djalin e saj E.(N.) P., me të drejtën e pronës prej ½ të ngastrave kadastrale dhe atë banesës me nr. O-71813068-02752-2-1033-5-36-0, ZK Prizren, në sipërfaqe prej 92 m², e udhëhequr sipas listës poseduese nr. 07-463/04-147694, të dt.21.10.2021, e cila gjendet në vendin e quajtur Tirana 1 VII 5 dhe garazhdës e evidentuar si ngaster kadastrale nr.O-71813068-02752-2-1033-166-0, ZK Prizren, në sipërfaqe të përgjithshme prej 14m², e udhëhequr sipas listës poseduese me nr. 07-463/04-147694, të dt.21.10.2021. Ndërsa të drejtën e pronësisë mbi paluajtshmëritë lëndore paditësja e ka fituar në bazë të trashëgimis nga bashkëshorti i saj N. P., ish nga P., në përputhje të plotë me dispozitën e nenit 12 par.1 të Ligjit mbi trashëgiminë, Ligji Nr. 2004 / 26 dhe nenit 36 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDS), Ligji Nr. 03/L-154. Kështu që paditësi përveç titullit juridik (justus titulus) për fitimin e të drejtës së pronësisë (shpalljen si trashëgimtarë ligjor), këtë të drejtë e ka regjistruar edhe në regjistrin kadastral (modus aquirendi), ashtu siç kërkohet me dispozitat ligjore të përmendura më lartë (të cilat vërtetohen nga certifikatat e pronësisë). Në anën tjetër pala e paditur nuk i ofroi gjykatës ndonjë provë të vlefshme materiale, e cila do të dëshmonte faktin se i padituri e ka të drejtën e pronësisë apo ka ndonjë bazë të vlefshme juridike në bazë të të cilën e ka fituar të drejtën e pronësisë në këto paluajtshmëri kontestuese, apo të dëshmonte se ka ndonjë bazë të vlefshme juridike në bazë të së cilës i njëjti e mban në posedim dhe shfrytëzim ngastrën kontestuese. Gjykata i ka vlerësuar edhe pretendimet e palës së paditur në lidhje me të drejtat eventuale pronësore të tij ndaj ngastrave kontestuese që janë objekt kontesti, përfshirë këtu pretendimet e tij se kanë kontribuar në blerjen e banesës dhe të njëjtën për shkak të afërsisë e kanë bartur në emër të djalit të tyre, por ka vlerësuar se të njëjtat janë të pabaza. Kjo për faktin se i njëjti gjykatës nuk i ka ofruar ndonjë provë materiale bindëse e cila do të mbështeste pretendimet e tilla. Po ashtu në këtë procedurë këto pretendime nuk kanë ndonjë ndikim për shkak të natyrës së këtij kontesti. Gjykata vendosi që ta refuzon propozimin e të autorizuarit të të paditurit për nxjerrjen e provës përmes dëgjimit të palës së paditur H.P., të dëshmitarëve H. P. dhe A. P., të propozuar në seancën kryesore të datës 27.06.2022, si dhe marrjen e provës me daljen në terren të propozuar në seancën e datës 01.08.2022, pasi vlerësoj se propozimet e tilla janë bërë me qëllim të prolongimit të këtij procesi gjyqësor. Faktet të cilat janë propozuar të vërtetohen përmes këtyre mjeteve provues nuk ishin kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse, pra vërtetimi i gjendjes shëndetësore të të paditurit dhe bashkëshortes së tij.

Ndërsa sa i përket dëgjimit të palës së paditur dhe dëshmitarëve me qëllim të vërtetimit të kontributit të tyre në blerjen e banesës, gjykata vlerësoj se dëgjimi i tyre është pa ndikim për shkak të natyrës së këtij kontesti. Andaj mbi këtë bazë edhe e ka refuzuar propozimin e paditësit për nxjerrjen e provës pemës dëgjimit të palës së paditur, dëshmitarëve dhe daljes në tere. Gjykata ka bërë vlerësimin edhe të provave të tjera të administruara dhe të përmendura më lartë, por vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në zgjidhjen meritore të kësaj çështje juridike.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori bazuar në nenin 452.1, lidhur me nenin 463, të LPK-së dhe TA-së, ku e obligoi palën e paditur që paditësit në emër të shpenzimeve procedurale ti paguajë shumën e përgjithshme prej 509,00 € dhe atë: për përpilimin e padisë 104 euro dhe për përfaqësimin në 3 seanca të mbajtura nga 135 apo shumën prej 405 euro (3x135=405).

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë. Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë. Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë dhe i kuptueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë.

Aktgjykimi i atakuar me ankesë është i rregullt në pikëpamje të strukturës dhe përmbajtjes duke përfaqësuar kështu një vendim i cili është koherent në pikëpamje logjike dhe juridike duke eliminuar çfarëdo kontradikte për ta kualifikuar si kundërtëhënës. Mënyra e zhvillimit të procedurës dhe e hartimit të vendimit nga gjykata e shkallës së parë kanë garantuar një proces të drejtë dhe të paanshëm duke u mbështetur për përfundimin e saj në themelin faktik dhe juridik të çështjes.

Gjykata e Apelit vlerëson të drejtë qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, duke shtuar se në rastin konkret paditësja me prova materiale, siç është certifikata e pronësisë ka vërtetuar se është pronare e banesës dhe garazhit objekt kontesti. Me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vendosur për lirim të pronës së paditëses, e cila ka mbështetur në nenin 93 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore “*Pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi*”, ndërsa në nenin 37 të LMTHJP parashihet “*Pronari mund të kërkojë me padi nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale*”, pra nga kjo shihet se ligji i referohet pronarit, e që në rastin konkret paditësja ka vërtetuar këtë fakt vendimtar përmes certifikatës së pronësisë se është pronare e parcelës kontestuese e përshkruara

në dispozitivin e Aktgjykimit të atakuar. Kjo e drejtë gëzon mbrojtje edhe nga konventat ndërkombëtare, përkatësisht Konventa evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore, neni 1 Protokolli nr.1. Padiësja mund të zhveshet nga këto të drejta vetëm në rastet e shpalljes së ineteresit të përgjithshëm nga organi kompetent dhe zbatimit të procedurës administrative të shpronësimit sipas Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme. Në bazë të certifikatave të pronësisë është vërtetuar se padiësja është pronare e parcelës kontestuese. Pronësia është ndër institutet ma të rëndësishme në të drejtën civile dhe si i tillë gëzon edhe mbrojtje juridike, kjo është e rregulluar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës në nenin 46; Ligjin për Pronësiën dhe të Drejtat Tjera Sendore Nr. 03/L-154, përkatësisht në kapitullin e VII të tij; Konventën Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Protokolli i Konventës së Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore në nenin 1.

Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsytimit të aktgjykimit. Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, të cilat i pranon edhe Gjykata e Apelit, ngase ky vlerësim nga ana e gjykatës së shkallës së parë, është i drejtë dhe profesional, prandaj pretendimet ankimore të të paditurit edhe në këtë drejtim tregohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e padiësit mbi këtë bazë, nuk qëndrojnë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese të cekura si në arsyetim të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e të cilat gjykata e shkallës së dytë nuk e pa të arsyeshme që t'i përsërisë edhe njëherë të gjitha, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimit. Drejtë është vendosur edhe në raport me shpenzimet e procedurës në këtë çështje juridike, i cili vendim është nxjerr në përputhje me nenin 449 dhe 452 të LPK-ës.

Padiësi është personii cili paraqet kërkesë në gjykatën e shkallës së parë me qëllim t'i jepet mbrojtje gjyqësore të përmabajtjes së caktuar për të drejtën e tij subjektive. Pra procedura civile inicohet me padinë e padiësit, i cili po ashtu përcakton palën e paditur në procedurë. Në rastin konkret kemi pasur në shqyrtim padinë dhe kërkesëpadinë e padiëses për lirim të pronës dhe se gjykata e shkallës së parë muk ka mundur të vendos për ndonjë kërkesë tjetër eventuale të të paditurit, e cila nuk është parashtruar konform dispozitave të LPK-ës (neni 256). Ne nenin 2.1 të LPK-ës parashihet "*Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse*". Pra gjykata e shkallës së parë ka detyrim të përcaktohet dhe të vendos vetëm brenda kufijve të kërkesave të palëve ndërgjyqëse, ndërsa në rastin konkret kemi vetëm një kërkesë të padiëses për lirim të pronës, e që në bazë të saj gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë Aktgjykimin e atakuar. Në këtë drejtim pretendimet e të paditurit janë të pabazuara.

Me rastin e shqyrtimit të ankesës, Gjykata e Apelit i mori parasysh edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palës ankuese, mirëpo të njëjtat, nuk patën ndikim në marrjen e një vendimi ndryshe nga ky që është marrë.

Nga të gjitha arsyet e cekura më lartë Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8047/2022, datë 19.03.2024

Kryetari i kolegjit,
Ardian Ajvazi